

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq, kryetare e kolegjit, Ferit Osmani dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit Q.M. , nga fshati ..., Komuna e Shtimes, për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhje e rëndë, nga neni 327 par 2 nënpar. 2.1 lidhur me par 1 të KPRK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Q.M.-Av. A.H., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.313/18, datë 25.05.2018, në seancën publike të kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPP-ës, më datë 20.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Q.M.-Av. A.H. , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.313/18, datë 25.05.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj me aktgjykimin P.nr.313/18, datë 25.05.2018, të akuzuarin Q.M. , për shkak të veprës penale në vazhdim Vjedhje e rëndë, nga neni 327 par 2 nën par. 2.1 lidhur me par 1 të KPRK-ës , e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgë në kohëzgjatjeje prej 1 viti e 3 muajsh e të cilin dënim do ta vuaj pasë plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Të akuzuarit i ka shqiptua edhe dënim me gjobë në shumë prej 500 € eurosh, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë. Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 31.01.2018 deri më datë 28.02.2018 , nëse dënimin me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara me nenit 46 par.3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € ndo të vuaj 1 ditë burgim. I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve e të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 60 € dhe shpenzimet e procedurës shumën prej 50 € në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë. Është detyruar i akuzuari që për kompensimin e viktimave të krimit që të paguaj shumën prej 30 €, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. Konform nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPRK-ës, si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar akuza ndaj të akuzuarit Q.M., pasi që prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare sa i përket propozimeve për shqiptimin e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, sipas numrave të lëndëve,

PP.II.nr. 1915-7/15 dt. 01.04.2016, PP.II. nr. 1921-7/15 dt. 12.04.2016, PP.II.nr.1935-7/15 dt. 04.04.2016, PP.II.nr 1938-8/15 dt 04.04.2016, PP.II.nr.1939-7/15, dt 12.0p4.2016 dhe PP.II.nr 220-7/16. Dt 26.01.2017, është tërhequr nga propozimi për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik respektivisht aktakuzës pasi që me rastin administratimit të provave nuk është vërtetuar se i akuzuari i ka kryer këto vepra penale për të cilat ngarkohet.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor për pjesën dënuese ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit av. A.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPRK-ës, dhe vendimit mbi dënimin me propozim që gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta kthej në rishqyrtim dhe rigjykim ose të njëjtën ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.870/2018, datë 15.08.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-ës e në të cilën i ftoj prokurorin e Apelit, mbrojtësin e të akuzuarit av. A.H., të akuzuarin Q.M. dhe të dëmtuarit. Në seancë prezantoj vetëm i akuzuari i cili mbeti në tersi pran pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesën e mbrojtësit të tij dhe shton se premtot se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe se nuk ka mundësi që ta paguaj dënimin me gjobë. Palët tjera edhe pse të njoftuara në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPRK-ës, duke pretenduar se i njëjti përmban shkelje të cilat konsistojnë në faktin se ky aktgjykim është i pa kuptueshëm, dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, sepse në hyrje theksohet u akuzuari, tek aktgjykimi dhe shpallja fajtor theksohet i pandehuri dhe disa mangësi tjera në bazë të të cilave aktgjykimi i atakuar duhet të prishet dhe të kthehet në rishqyrtim. Gjithashtu në dispozitivin nën 1 të aktgjykimit nuk është theksuar shumica e të hollave për sendet e përvetësuar në këtë rast të cigareve të llojeve të ndryshme në shitoren e të dëmtuarit B.R., e siç dihet vlera e sendeve të përvetësuar është një nga elementet kryesore për ekzistimin e figurës së një veprë penale. Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e tij theksoi se gjykata nuk veproi drejt kur mori parasysh mendimin e ekspertit të forenzikës psikiatrike nga Dr. B.O. i cili deklaroi se i akuzuari mund të marrë pjesë në këtë proces gjyqësor sepse është i aftë për tu deklaruar dhe përballur me këtë gjykim sipas aktakuzave dhe propozimeve për mjekim psikiatrik në liri, është i aftë të kuptoj veprimet dhe pasojat nga kryerja e veprave penale dhe se

ka pranuar fajësinë e tyre, mirëpo i akuzuari vuan nga çrregullimet mendore-retardim i lehtë mendor, me shifrën F-70.0/ICD-10 e që ky çrregullim karakterizohet me gjendje të mos zhvillimit psikik, deficite të disa aftësive gjatë periudhës së rritjes dhe zhvillimi të individit, dhe rrethana nga të cilat rezulton pa përgjegjshmëria e tij në momentin e kryerjes së veprave penale që i bihen në barrë, kështu që eksperti i forenzikës edhe përkundër kësaj pohon se i njëjti është i aftë për ti kuptuar sjelljes e veta dhe nuk përjashtohet nga përgjegjësia penale e të cilat vlerësime i kundërshtojmë në tërësi sepse të njëjtat nuk përkojnë me gjendjes faktike shëndetësore të të akuzuarit.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate pretendimet e lartë cekura të mbrojtësit të të akuzuarit nuk qëndrojnë. Edhe pse qëndron pretendimi i mbrojtësit të të akuzuarit se në dispozitivin I të aktgjykimit nuk është theksuar shuma e të hollave për sendet e përvetësuara prap se prapë kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në rastin konkret për ekzistimin e veprës penale të vjedhjes së rëndë përpos vlerës së dëmit duhet që të plotësohet edhe elementi tjetër e që është përdorimi i forcës e që në rastin konkret kemi “ thyerjen e drynit të dyqanit “ e që me këtë edhe plotësohet elementi qenësor i veprës penale të vjedhjes së rëndë si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar. Po ashtu sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate nuk qëndron as pretendimi i mbrojtësit të të akuzuarit se i mbrojturi i tij nuk ka qenë i aftë që ti kuptoj sjelljet e veta dhe se në momentin e veprimit të tij ka qenë i pa përgjegjshëm për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Lidhur me këtë kundërshtim të mbrojtësit mendimin e ka dhënë eksperti i forenzikës psikiatrike Dr. B.O., i cili përshkroi gjendjen shëndetësore të të akuzuarit Q.M. duke konstatuar se i njëjti vuan nga çrregullimi mendor-retardim i lehtë mendor, me shifrën F-70.0/ICD-10 e që ky çrregullim karakterizohet me gjendje të mos zhvillimit psikik, deficite të disa aftësive gjatë periudhës së rritjes dhe zhvillimi të individit, dhe konstaton se i njëjti është i aftë që ta përcjell shqyrtimin gjyqësor, dhe se në momentin e kryerjes së veprimeve të tij inkriminuese ka qenë i aftë që ti kuptoj veprimet dhe pasojat nga kryerja e këtyre veprave penale, se është i përgjegjshëm për këto vepra penale me të cilat ngarkohet me aktakuzë. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë e pranoj mendimin e ekspertit në fjalë dhe se mendimi të të njëjtit i kushtoj besimin e plotë. Kjo gjykatë po ashtu duke u përkujdesur sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat do të kushtëzonin anulimin e këtij aktgjykimi.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit mbi dënimin duke theksuar në ankesë së dënimi i shqiptuar është shumë i rëndë e nëse merën parasysh rrethanat lehtësuese të konstatuara në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe faktin se i akuzuari premtan se nuk do të përsëris vepra të tilla penale, është i pa punë dhe gjendjen e tij të vështir ekonomike nga të gjitha këto propozon që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të mbrojturit të tij ti shqiptohet dënim më i butë me burg dhe gjobë ose që aktgjykimi të priset dhe të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim-rishqyrtim të serishëm. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, konform nenit 73 të KPRK-ës, morri parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarin ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen do të kryej vepra penale, është i gjendjes së varfër ekonomike,

dhe në veçanti gjendjen e tij shëndetësore pasi që i njëjti vuan nga një çrregullim mendor F-70 – ICD-10 , ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, karakteristikat e tij personale, pasi që i njëjti dyshohet për kryerjen e më tepër se 60 veprave penale, vendosmërinë e tij për kryerjen e këtyre veprave penale, për kundër premtimit se nuk do të përsërisë vepra të tilla penale dhe të akuzuarit në prezencë të këtyre rrethanave i shqiptoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar se edhe me këtë dënim (kumulativ me burg dhe gjobë) me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KRPK-ës. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit për një dënim më të butë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimi i shqiptuar(kumulativ me gjobë dhe burgim) është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re lehtësuese, që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e që do të ndikonte në një dënim më të butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e peronave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KRPK-së.

Pjesa refuzuese e aktgjykimit ngel e pashqyrtuar ngase për këtë pjesë nuk kemi ankesë të palve.

Nga të cekurat më lartë konform të dispozitave të nenit 401 të KPPK-s u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr 866/18, datë 20.09.2018

Zyrtari ligjor
Bujar Ahmeti

Kryetare e kolegjit
Biljana Rexhiq

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Afrim Shala